



KOMUNA E KLINËS  
KUVENDI I KOMUNËS  
01.NR. *06-6927/17*  
KLINË, 20.9.2017

**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT  
I SEANCËS SË IX-të TË KK, MBAJTUR, MË 20.9.2017, NË ORËN 10,  
NË SALLËN E KK**

Në seancë prezantuan: kryetari i Komunës, Sokol Bashota, kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, nënkryetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e KK-së, drejtorë të drejtorive, KFOR-i, komandanti i Policisë në Klinë, Rexhë Berisha, OSBE, Zyra ligjore, Zyra e Auditimit, OJQ “Koha”, mediet, etj.

Seancën e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë të fundit për këtë legjislaturë të KK-së.

**Haxhi Ibishi**, tha se në emër të trupave të Komunës dhe grupeve parlamentare të KK, jemi dakorduar për një seancë solemne të një përmbyllje të një mandati 4- vjeçar që ne e konsiderojmë të suksesshëm të kësaj përbërje, mandat i cili, sigurisht që ka pasur edhe sfidat e telashet veta dhe mandat i cili po përfundon dhe po lë gjurmë të zhvillimit dhe të pluralizmit politik në Klinë.

“Ne e kemi ndarë në dy pjesë këtë seancë: Pjesa e parë do të jetë pjesë solemne dhe pjesa e dytë, procedimi i seancës sipas pikave të rendit të ditës. Unë në fund të këtij mandati dua t’ju falënderoj të gjithëve për punën, për përkushtimin, që keni pasur. Falënderoj kryetarin Bashota me stafin e tij për bashkëpunimin që ka treguar në AK, dhe mbi të gjitha falënderoj partinë dhe koalicionin i cili mua me ka besuar së bashku me opozitën e cila më ka mbështetur në projektet e përbashkëta që kanë qenë. Falënderoj përfaqësuesit të KFOR-it, që kanë qenë vazhdimisht, të OSBE-së, të medieve, dhe të organizatave joqeveritare të cilat na kanë kritikuar aty ku ata kanë vlerësuar, se ka qenë kritikë pa argumente që ne kemi vlerësuar ose jo, që ka qenë në funksion të shëndoshës që Klinës i nevojitet. Kjo AK ka lënë gjurmë të veta, ka marrë 4-5 vendime me unanimitet të plotë, të cilat mendoj që kanë për t’i rezistuar kohës. Dhe ato vendime në qoftë se i rezistojnë kohës do të na jep të drejtë që ne kemi qenë të suksesshëm. Më lejoni t’i potencoj ato vendime që kjo asamble ka marrë me shumicën dërmuese ose të them të qind për qind të votave

tuaja: Emërtimin e rrugëve, të shesheve dhe institucioneve publike, që ka qenë një brengë e madhe për Klinën; vendosjen e 4 Prillit si ditë zyrtare të të pagjeturve tanë; vendosjen në vend të 2 Korrikut dhe 7 Shtatorit si vijimësi e çlirimit tonë, përkatësisht të shqiptarëve dhe popujve të Kosovës; pastaj nxjerrjen e një rregulloreje për ndarjen e dekoratave, titujve, edhe mirënjohjeve të veçanta, ku me theks të posaçëm kisha vlerësuar: mirënjohjen për komandantin legjendar Mujë Krasniqi, që është zyrtarizuar me titullin e veçantë, për njeriun e penës sonë, Tahir Deskun, pastaj dy mirënjohje që jepen për dy lëmi, që do të japin në të ardhmen asamblistët ose Kuvendi i Komunës së Klinës për kontributin në shëndetësi për z. Azem Desku, i cili ka rënë në luftën e fundit dhe kontributin për arsim, për drejtorin e parë të gjimnazit “Luigj Gurakuqi”, ende gjallë, të madhin prof. Frrok Gojani. Prandaj, me urimin më të mirë, që asambleja e ardhshme të jetë më e fortë, në aspektin intelektual, më kompetente, më e përgjegjshme, edhe sigurisht do të jetë më e mirë se sa kjo që ka qenë, se progresioni i revolucionit në demokraci, mendoj që do të ngadhënjejë. Unë me secilin prej jush kemi përgatitur nga një mirënjohje në shenjë falënderimi për bashkëpunimin që kemi pasur bashkë dhe për kontributin që ju keni dhënë në këto vendime tona”, ka konstatuar kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi.

**Grishë Gashi**, shefe e Shërbimit për Punë të Kuvendit, në emër të Shërbimit për Punë të Kuvendit falënderoi anëtarët e KK për bashkëpunimin dhe angazhimin e përbashkët në mes vete, duke ju dëshiruar suksese në të ardhmen.

Në vijim kryesuesi me stafin e tij për anëtarët e KK ndau mirënjohje.

**Prend Buzhala**, u prezantua me një fjalë përshëndetëse dhe mirënjohje për Kuvendin.

**Pjetër Coli**, në cilësinë e anëtarit më të moshuar në emër të Kuvendit ndau mirënjohje për Kryesuesin e Kuvendit, Dr. Haxhi Ibishin.

**Dr. Haxhi Ibishi**, kryesues i KK, në emër të KK, ndau mirënjohje për kryetarin e Komunës, z. Sokol Bashota. Mirënjohjen në emër të Kryetarit Bashota e pranoi, Enver Berisha, nënkryetar i Komunës së Klinës.

**Enver Berisha**, nënkryetari i komunës së Klinës, u prezantua me një fjalë rasti, i cili njëherësh përshëndeti dhe falënderoi anëtarët e KK për kontributin dhe bashkëpunimin që kanë pasur me ekzekutivin e Komunës së Klinës.

**Tunë Dedaj**, në emër të GP të AAK-së falënderoi dhe i përshëndeti të pranishmit për kontributin e dhënë dhe bashkëpunimin e ndërsjellë për këto katër vite. “Më vjen keq, megjithatë më duhet të konstatoj se për këto katër vite nuk kemi mundur që t’i realizojmë objektivat tona”, shtoi anëtari Dedaj.

**Ramush Agushi**, tha se kam për obligim pasi që nuk do të jem kandidat për këshilltar të AK, t’ju falënderoj për bashkëpunimin. “Po ashtu falënderoj edhe qytetarët, përkatësisht përkrahësit e mi, të cilët për këto tri mandate sa përfaqësoj në Kuvend më kanë dhënë votën. Është me rëndësi që

bashkëpunimi ynë në Kuvend te interesi i qytetarëve ka qenë i përbashkët”, ka shtuar ndër të tjera anëtari Agushi.

**Ndue Shabanaj**, tha se po rrumbullakojmë një aktivitet tonë katërvjeçar, si përfaqësues të popullit. “Falënderoj kryesuesin dhe gjithë juve për gjitha format e bashkëpunimit dhe për marrjen e vendimeve. Të gjithë kanë qenë në shërbim të demokracisë. Për këto vite në Kuvend ka ekzistuar një klimë e mirë. Kemi pasur mendime dhe qëndrime të ndryshme. Kemi bërë përpjekje për t’i realizuar kërkesat e qytetarëve. Janë marrë vendime të ndryshme, që kemi qenë unanimisht në vendime të mëdha. Ju falënderoj për bashkëpunim, falënderoj kryesuesin dhe gjithë juve”, është shprehur ndër të tjera anëtari Shabanaj.

**Halil Desku**, tha se në emër të GP të PDK-së ju përçoj një falënderim të veçantë për kontributin dhe bashkëpunimin që kemi pasur për këto vite në Kuvend dhe për cdo gjë që kemi bërë në interes të qytetarëve.

**Bozhidar Sharkoviq**, tha se në emër të Listës Serbe ju falënderoj të gjithëve! “Për këto vite kontributi im nuk ka qenë edhe aq i frytshëm, mirëpo mendoj që në mandatin e ardhshëm do të jem më aktiv dhe më i frytshëm. Ju uroj zgjedhje të suksesshme!”, është shprehur anëtari Sharkoviq.

**Sokol Bashota**, tha se verdikti i qytetarëve përcakton se kush duhet të vazhdojë mandatin dhe kujt i ndërpritet mandati. “Pavarësisht dallimeve që kemi pasur, ju falënderoj të gjithëve, falënderoj partnerët e koalicionit dhe falë mbështetjes së tyre dhe rezultateve, Klina ka marrë një performancë të shkëlqyeshme. Nga organizata gjermane GIZ Klina fiton vendin e parë në Kosovë, me c’rast fiton një donacion në vlerë prej 29 300 euro, që është kontribut i drejtorit të Drejtorisë së SHP, z. Gjokë Lleshit dhe zyrtarit Dardan Bashotës. Po ashtu, për shkollën e Jagodës nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik janë ndarë mjete në vlerë prej 600 mijë euro, që do të thotë nga totali shuma e mjeteve rritet për 15 për qind. Ju falënderoj për kontributin dhe bashkëpunimin që kemi pasur për këto vite. Konsideroj se duhet lënë vendin që të takohemi sy më sy. Suksese të gjithëve në angazhimet tuaj dhe qofshi faqebardhë në sfidat!”- ka shtuar kryetari Bashota.

Kryesuesi ftoj anëtarët për një pauzë një orësh për nga një kafe të përbashkët.

Në orën 11.30 minuta u procedua me vazhdimin e pjesës së dytë të seancës.

**Haxhi Ibishi**, vazhdojmë me pjesën e dytë të seancës. Rendin e ditës e keni marrë me kohë. Hapi diskutimin rreth rendit të ditës. Nuk pati diskutime rreth rendit të ditës. Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës

**Me vota unanime (21) u miratua ky**

## REND I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të dy seancave të fundit,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-buxhetit dhe të projekteve të Komunës për vitin 2018-2020,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre,
5. Të ndryshme.

### **Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.**

Kryesuesi sqaroi se ka arsyetim për mungesat e dy anëtarëve (me arsye), të Pal Berishës, I cili ndodhet në Amerikë, po ashtu edhe të Rasim Millakut, i cili aktualisht është zgjedhur drejtor i Qendrës së Mesme Teknike “Fehmi Agani”.

### **Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të dy seancave të fundit.**

Kryesuesi foli rreth procesverbaleve. Janë mbajtur dy séance të KK, prandaj I kemi dy procesverbale të këtyre seancave. Hap debatin rreth këtyre procesverbaleve.

**Vlora Tafili**, tha se në emër të Grupit të Grave Asambliste, ju përshëndes dhe ju falënderoj për bashkëpunimin që kem i pasur për këto vite të kësaj legjislature të KK-së. Në vijim, duke folur për procesverbalet, anëtarja Tafili tha se kam vërejtje rreth procesverbaleve, ngase diskutimet e mia janë të përgjysmuara, po ashtu edhe në aspektin e lekturimit nuk janë në rregull. “Nuk di, në mos vetëm te diskutimet e mia po ndodhen këto lëshime”, theksoi anëtarja Tafili.

**Pjetër Coli**, pati vërejtje, rreth procesverbalit. “Në seancën e fundit i kam prezantuar disa vendbanime për t’u përfshirë në prioritet, mirëpo në procesverbal nuk figurojnë ato projekte dhe ato vendbanime”, shtoi anëtari Coli.

**Tunë Dedaj**, theksoi se propozimet e projekteve që i kam potencuar në seancën e fundit nuk janë të prezantuara në procesverbal.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi se janë në rekomandimet e KPF-së.

Kryesuesi vuri në miratim procesverbalet me vërejtjet e bëra.

**Me vota unanime u miratuan procesverbalet e seancave të fundit.**

**Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i draft-buxhetit dhe të projekteve të Komunës për vitin 2018-2020.**

Kryesuesi foli rreth pikës në rend të ditës. Fjalën për raportim e barti te drejtori i Drejtorisë së FEZH, z. Ramiz Rrusta.

**Ramiz Rrusta**, raportoi rreth draft-buxhetit dhe të projekteve të Komunës për vitin 2018-2020.

“Uroj KFOR-n slloven për fitoren në Kampionatin European të Basketbollit! Ju uroj edhe për mirënjohjet anëtarëve të KK dhe stafin udhëheqës. Opinioni im është që kemi punuar bashkë dhe vërejtjet e opozitës i kam marrë në mënyrën më serioze, sepse kam konsideruar se ky buxhet është buxhet i gjithë qytetarëve. Të gjithë hapat janë marrë për këtë draft-buxhet. Vlera e buxhetit për vitin 2018 është 9 milionë e 488 mijë e 703 euro. Prej tyre, 5. 733. 598 euro janë për paga dhe mëditje, 869. 878 për mallra dhe shërbime, 151. 258 për komunal, 65. 767 për transferë dhe subvencione, ndërsa 2 milionë e 668 mijë e 202 euro për investime kapitale që krahasuar më këtë vit shënon rritje. Sa i përket investimeve kapitale, për Drejtorinë e Arsimit janë paraparë 202. 818 euro, shëndetësi 40 mijë euro, administratë 15 mijë, inspektorat 15 mijë, shërbime publike 220. 000 euro, kadastrë 13 mijë, bujqësi 46.500 euro dhe urbanizëm 2 milionë e 115 mijë e 884 euro. Projektet e planifikuara për 2018, janë orientuar në ndërtimin, rregullimin, riparimin, rinovim, të objekteve shkollore, urgjencës, kanaleve të ujitjes pastaj kanalizim, asfaltim të rrugëve, mirëmbajtje të rrugëve, ndreqim publik, ndërtim të ujësjellësit e tjera. Ekziston edhe një kod i veçantë bashkëfinancim me donatorë në të cilën qeverisja komunale planifikon të realizojë edhe projekte të tjera që nuk janë në listën e projekteve të planifikuara, kryesisht në bashkëfinancim me qytetarë, qeverinë apo ndonjë donatorë të jashtëm apo të brendshëm. Është punuar me drejtor të drejtorive. Kufijve buxhetorë nuk mund t’u ikim. Kemi paraparë buxhetin për 10 drejtori dhe prioritetet prioritare”, ka raportuar drejtori, Rrusta.

**Baki Gashi**, drejtor i Urbanizmit, arsyeton një gabim teknik në projektin e rrugës Stapanicë – Rixhevë - Gllarevë, ku sipas tij është shënuar dy herë. Duhet të jetë, “asfaltimi i rrugës në lagjen Dragaj. Edhe një arsyetim rreth mjeteve bashkëfinancim me donatorë. Ne kemi pasur disa marrëveshje me MI, në bazë të memorandumit të nënshkruar dhe në dy projekte ata kanë bërë preje buxhetore, ne jemi të obliguar pasi që operatorët ekonomik, me të cilët është bërë kontrata, e kemi qitur shumën në këtë kod, dhe mbetja e pagesave të 10-përqindëshit është paraparë në këtë, bashkëfinancim me donatorë. Pra, kërkoj të bëhet përmirësimi, asfaltimi i rrugës në lagjen Dragaj, të 15 mijë euro, është përsëritur dy herë”, ka sqaruar drejtori Gashi.

Kryesuesi hapi debatin.

**Tunë Dedaj**, tha se në jetën time gjithmonë kam pasur dëshirë për ta votuar buxhetin, por këtë buxhet që ka ardhur tash, ky është buxheti më i keq që mund të ekzistojë në Komunën e Klinës. Kryesisht dua të ndalem te DU, ku janë të parapara 2 15000 euro për t'u investuar, prej kësaj vlere 2 50 00 euro dhe 30 mijë euro në Zajm, që unë e përkrahi që shtrohet ajo rrugë, janë në zonën nga vi unë, në Lug të Drinit. Disa herë kam bërë përpjekje për t'u investuar në ato fshatra që paguhet tatimi në pronë më mirë. Nuk investohet aty ku paguhet tatimi në pronë, ndërsa investohet aty ku as 30 për qind nuk paguhet tatimi në pronë. Unë e votoj buxhetin, nëse parashihet që më 2018 të përfshihet kanalizimi në Zajm, kanalizimi në Deiq, asfaltimi te rruga e Elshanëve, në Deiq, që është edhe e Haradinjave; të parashihet kanalizimi në Videjë, kanalizimi në Krushevë të Vogël, edhe në Radulloc, unë e votoj. Për ata qytetarë jam këtu. Këtë buxhet në këtë mënyrë nuk mund ta votoj asnjëherë. Buxheti të ndahet në mënyrë të barabartë, askush të mos lihet anësh. As sugjerimet e mbledhjes së fundit nuk i keni paraparë, të cilat nuk janë të përfshira as në proces sot. Edhe rruga në qendër e ka devijuar drejtimin, është prishur, ku trotuari është ardhur në shkallën zero. Kisha kërkuar nga ju kryetar që të angazhoheni dhe projekti le të shkojë në mënyrë të drejtë”, ka konstatuar Dedaj.

**Vlora Tafili**, tha se nuk do të ndalem te DU që më shkuan 4 vjet duke dhënë kritika të ashpra kësaj drejtorie, por po vërej që i paskeni bërë disa lëvizje pasi që është edhe vit i fushatës, desha të ndalem tek disa drejtori tjera, duke filluar te Drejtoria e Kadastrit. Po më vjen keq për këtë drejtori qysh ju kanë ndarë vetëm 13 mijë euro. Unë nuk di qysh punojnë këta në këtë drejtori dhe qysh performojnë me kaq pak mjete. Edhe te Drejtoria e Bujqësisë është dashur të kemi sa më shumë pjete, vlere 46 mijë euro është tepër e vogël për këtë drejtori, duke e ditur faktin që Klina ka nevojë për zhvillimin dhe avancimin sa i përket bujqësisë. Është turp për gjendjen e mjerueshme që ka shëndetësia në Klinë, 40 mijë euro. Çfarë do të bëni me këto 40 mijë euro? Me çka do të punojnë, kur është vaksinimi, diagnostifikimet, ku në qendrat e mjekësisë familjare mungojnë edhe elementet më të vogla. Me intereson qysh është duke u furnizuar Klina rreth listës esenciale të barnave esenciale, pra kisha dashur të di si është gjendje në këtë segment, mirëpo fatkeqësisht drejtori nuk gjendet prezent dhe mbes pa përgjigje”, pohoi anëtarja Tafili.

**Avni Gashi**, tha se sa i përket buxhetit po ndalem ta krahasoj me atë kanë qenë më herët me këto që janë planifikuar tash. “Unë do të ndalem për këto që janë përfshirë në këtë buxhet. Prej Çabiqit, në vitin vijues, përkatësisht vitin e kaluar kanë qenë të planifikuara 100 mijë euro për ujësjellës. Në këtë vit zgjedhor, domethënë është ndarë, në dy pjesë: 60 mijë për ujësjellës dhe 25 mijë për rrugë lokale. Dhe kjo shihet në ç'bazë është ndarë shuma prej 100 mijë euro dhe në bazë të ç'kahit janë hequr ato 15 mijë euro, pra dhe është ndarë projekti në dy pjesë. Tjetër problem që po e shoh te kjo, që është që s'është

përfshirë një rrugë e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme, rruga në mes të fshatrave Sferkë dhe fshatit Përqevë, për arsye se është për vitin 2019, Kisha propozuar që për ta aprovuar buxhet, që atij lokaliteti për t'ia shtuar, këtë 300 mijë euro për ta marrë nga bashkëfinancim me donatorë dhe projektin e paraparë për 2019 me qenë për vitin 2018 dhe me u bashkëngjitur fshati Sferkë me Përqevë, ku ne e dimë rëndësinë e saj dhe mund të flasim me orë të tëra, por këtë e kisha kërkuar, ishte shkurtuar rruga që nuk kishin pasur të udhëtojnë nga 15 km për të shkuar deri në Sferkë dhe Përqevë”, ka shtuar anëtari Gashi.

**Marie Selmani**, tha që për tre mandate nuk kam parë një projekt për Radullocin. “I pashë disa projekte të rrugëve lokale nëpër disa fshatra, mirëpo nuk po e kuptoj për fshatin Radulloç për çka është fjala. Këtu thotë” asfaltimi n rrugës në Radulloç”, për cilën rrugë bëhet fjalë, kërkoj sqarim, shtoi anëtarja Selmani.

**Bozhidar Sharkoviq**, tha se dëshiroj ta kemi në garanci nga kryetari që neve në Videjë na nevojitet një qendër kulturore arsimore. “Nuk është ndonjë investim i lartë, rreth 85 mijë euro. Desha të siguroj në farë garancioni a do të përfshihet në buxhetin për vitin 2018. Unë do ta votoj buxhetin”, shtoi ai.

**Skënder Merturi**, tha se po filloj te DKA, me gjithë këto punë që mendohet për t'u bërë, veç po shihet vetëm ndërtimi i fushës sportive në Jashanicë, Këpuz, Përqevë. Nuk po shoh këtu te DKA që është planifikuar që shkollat që i kemi të pajisen me kabinate përkatëse, duke filluar nga kabinetet e informatikës, kimisë, biologjisë etj. Domethënë arsimin profesional i nxënësve të komunës së Klinës, nuk po e shoh në këtë buxhet, është menduar dhe planifikuar vetëm ndërtim i fushave sportive, që është mirë, por jo diçka konkrete në arsimin profesional të nxënësve. Te drejtoria e Shëndetësisë, “rinovimi i urgjencës”. Për mendimin tim duhet të bëhet ndërtimi i urgjencës, jo rinovim, por të ndahet tërësisht nga ajo ku është dhe të ndërtohet nga fillimi dhe me të gjitha pajisjet përcjellëse, jo vetëm rinovim, sepse rinovimi nuk e zgjedh problemin e emergjencës. Administrata, nuk e di, është përfshirë vetëm rregullimi i zyrës së vendit në Gllarevë, nuk po shihet që është planifikuar diçka tjetër. Drejtoria e SHP, po shihen shumë gjera që ka këtu: mirëmbajtja e kanalizimeve, mirëmbajtja e rrugëve, po nuk po thuhet cilave rrugë edhe konkretisht. Është e përshkruar vetëm në vija të trasha , por nuk është sqaruar në detaje, cila rrugë, cili kanalizim dhe cili ndriçim. Cilat pjesë e qytetit, përkatësisht cila rrugë ka për t'u ndriçuar. Të detajizohet. Drejtoria e Kadastrit, 13 mijë euro, nuk ka asgjë tjetër. Drejtoria e Bujqësisë: kanali për ujitje, a nuk ka diçka tjetër që duhet bërë në DB apo vetëm kanale për ujitje. Për këto katër vjet janë bërë vetëm ndërtime kanale për ujitje, kur dihet që bujqësia është një fushë shumë e rëndësishme për zhvillimin e komunës sonë, dhe si Klinë e kemi klimën e përshtatshme për bujqësi, por jo vetëm për ndërtimin e kanaleve të ujitjes. Mendoj që duhet pasur të përfshira edhe gjera të tjera

konkrete. DU, për mua e merr atë investimin më të madh, por për mendimin tim prapë po e potencoj se DU ka shkuar me plotësimin e kërkesave të kryetarit të komunës për zgjedhjet lokale. Janë përfshirë disa gjera që kanë qenë të përfshira edhe më herët edhe nuk kanë përfunduar edhe tash janë qitë në buxhet që kryetari në largim mendon të merr vota prapë, edhe unë mendoj që secili do kryetar që vjen duhet për ta rishikuar këtë buxhet, sidomos te DU. Nuk është e përfaqësuar mirë hapësira gjeografike e komunës të Klinës te DU. Më shumë është përfaqësuar aty ku mendohet të merr vota PDK dhe jo pjesë tjera të Komunës së Klinës. Është një gabim në hartim të buxhetit edhe është një gabim në logjikë të ndërtimit të buxhetit. Nuk po e vërej DKRS, a do të hiqet kjo drejtori nëse fiton ky kryetar apo çka? Thjesht, a është menduar diçka për rini, kur ne gjithherë thirrrem tek të rinjtë tanë. Për mendimin tim ky buxhet është buxhet i planifikuar për zgjedhjet lokale”, ka shtuar anëtari Merturi.

**Enver Gashi**, tha se i përkrahi të gjitha projektet për 2018-2020, mirëpo kërkoj që të shikohen mundësitë buxhetore që të përfshihen edhe disa projekte në BL të Sferkës, sic janë: riparimi i ujësjellësit të Sferkës, ku banorët e këtij lokaliteti që 5 vite nuk kanë ujë nga ujësjellësi për shkak të mos funksionimit. “Po ashtu edhe rregullimin e rrugës së shkollës, që është një rrugë shumë e ngishte, nuk ka trotuar, nuk ka shenja sinjalizuese, prandaj nxënësit janë të rrezikuar nga automjetet. Po e përkrahi po ashtu propozimin e Avniut, që edhe projekti i rrugës Sferkë - Përqevë të hyjë në 2018, se është një projekt me rëndësi dhe është me rëndësi të përfundojë më herët. Te projektet e vitit 2010 ku janë të parapara ndërtimi i fushës së sportit në Dëshmorët e Kombit, 16 mijë euro që është prapë e përsëritur, ndërtimi i fushës së sportit, këtu 17 mijë euro”, shtoi anëtari Gashi.

**Vlora Tafili**, tha se një kërkesë më ka mbërritur te Komiteti për Politikë dhe Financa nga Grupi lokale i grave aktive e cila vepron në Komunën e Klinës. “Ne kemi mbajtur takime, tryeza dhe nga këto kanë dalë disa kërkesa me prioritet për Komunën e Klinës. Pse nuk është e parapara në buxhet asnjëra nga këto projekte prioritare për 2018, për ta integruar perspektivë e gruas në buxhetim”, shtoi anëtarja Tafili.

**Arben Limani**, tha se fillimisht pajtohem me propozimin e Avniut lidhjet e dy fshatrave Sferkë – Përqevë, ndoshta është dashur t’i kushtohet prioritet për 2018 kësaj rruge, pasi që është e nevojshme për banorët lokal. Konsiderojmë që është dashur të jetë në prioritet për vitin 2018. Desha një sqarim, rreth ndërtimit të sh.f. në Cerovik, a bëhet fjalë për rinovimin apo për ndërtimin komplet të kësaj shkolle. Te pjesa e DSHP, këtu është paraparë një shumë prej 50 mijë euro për sinjalizim të rrugëve me shtylla dhe emra të rrugëve, sa di unë në Kuvend na është thënë se vendosja e tabelave me emra të rrugëve është donacion nga një fondacion i huaj, kështu na është thënë, tash nuk e di po që se ka mundësi të na sqarojnë. Gjithashtu edhe te DSH vërejtja jonë është se nuk janë planifikuar investime, mund të them investime minimale, kur e dimë gjendjen jo të mirë



në shëndetësi. Këtu janë paraparë shumë pak investime. Një sqarim tjetër desha, është paraparë te rrugët në fshatin Bokshiq, me dy lagje, lagjja Fazliu dhe Gryka, nuk e di cilën pjesë e përfshin, a e përfshin këtë lagjen e muhaxherëve apo pjesën lart atje. Gjithashtu projekti i emrave të rrugëve është paraparë edhe në vitin 2019, nëse ka mundësi edhe këtë sqarim, domethënë nuk e di sa mund të jetë i kushtueshëm ky projekt që zgjat dy vjet, vendosja e tabelave të emrave të rrugëve”, ka konstatuar anëtari Limani.

**Ndue Shabanaj**, tha se dua të bëj përpjekje për të mos e prishur këtë klimën e seancës së fundit të AK, megjithatë ne po shqyrtojmë këtë pikë të rëndësishme të rendit të ditës e cila domosdo na qetë për të pasur mendime të ndryshme, për të pasur edhe kërkesa të ndryshme, por nganjëherë edhe pajtueshmëri. “Dua të them një konstatim që e kam përsëritur për 17 vjet që kam kërkuar shpërndarjen proporcionale të investimeve kapitale për një zhvillim të balancuar të Komunës së Klinës. Më vjen keq që kjo është përsëritur për 17 vjet, mirëpo nuk ka ardhur në shprehje për t’u realizuar. Planifikimi i buxhetit që bëhet nga pushteti lokal duhet për të pasur në radhë të parë këtë çështje. Uroj, më në fund për ta parë, për ta nxjerrë një pasqyrë ekzekutivi komunal cilat janë fshatrat që për 17 vite nuk kanë realizuar asnjë projekt. I kam potencuar me emër, por prapë e shoh që nuk janë në këtë buxhet 2018-2010. Është e thjeshtë kjo punë, fshatrat që i kanë të realizuar dy projekte më të rëndësishme këto janë kanalizimi dhe ujësjellësit dhe këta fshatra nuk kanë asnjërin prej tyre. Është lehtë për ta nxjerrë një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes në komunë dhe mos me pasur nevojë për diskutime, shqetësime, por me i orientuar aty ku nuk janë orientuar këto investime për 17 vjet”, ka konstatuar prof. Shabanaj.

**Pjetër Coli**, tha se unë dua vetëm ta konkretizoj këtë çka e tha profesor Ndou, i cili po heziton për të potencuar emra. “Unë personalisht nuk mund të pajtohem me faktin që Krusheva e Vogël nuk është nuk listën e fshatrave për kanalizim, i cili është premtuar që 4 vjet. E dyta, disa herë për Sferkë kemi biseduar këtu se janë në një situatë shuam të keqe për ujë të pijshëm. Në atë fshat banorët bartin ujë me ato enët, të njëjtën gjë e bëjnë edhe të Krushevës së Vogël, edhe pse ky fshat shtrihet mu buzë lumit Drini i Bardhë. Ata problemin e ujtë të pijshëm nuk e kanë zgjedhur se ka dështuar projekti i ujësjellësit edhe pse kanë participuar vetë dhe askush nuk është marrë në përgjegjësi pse ka dështuar ai projekt. Unë nuk e shoh të rrugës që Krusheva e Vogël për të mbetur jashtë këtyre fshatrave që janë propozuar këtu për investime të kanalizimit dhe ujësjellësit. E njëjta vlen edhe për Deiqin. Deiqi duhet të futet në prioritet sidomos për kanalizim. Këtu thotë: “Të bëhet ndriçimi i rrugës nga Premarket deri te Ura”. Me librat kadastralë ajo pjesë nuk i takon Klinës, është Dresnik. Qysh mund të planifikohet ndriçimi deri te ura dhe nuk mund të planifikohet ndriçimi deri te lagjja ime. Edhe ne jemi pjesë e qyteti, kjo nuk është në rregull edhe votuesi thotë çka është duke u bërë me ne. Këto gjera të dhembin. E di që me këtë fjalim timin mandati im përfundon, nuk do të kem mundësi tjetër kurrë për

të kontribuar për këto probleme, madje le të mbetet në procesverbal, se është cekur, edhe po që se nuk bëhet kurrë, bile ta dimë se janë cekur këto gjera, të cilat janë të padrejta.

**Ndue Shabanaj**, tha se unë hoqa dorë nga ajo për t'i potencuar emrat, jo pse nuk i kam, por pse i kam përmendur këtu. “Dhe nëse e themi diçka e cila botërisht është e ditur atëherë jemi duke e banalizuar punën. Nuk ka nevojë punët e ditura dhe të njohura të përsëriten disa herë edhe me emra, edhe për t'u krijuar një farë bindje se dikush paska ndonjë qëllim të caktuar për të orientuar dika investimet. Gjithmonë kam dhënë kritika, por duke mos bërë përpjekje për të lënduar. Kam dhënë kritika me qëllim të përmirësimit, por gjithmonë e kam pasur parasysh mos të lëndoj çështjen e përgjithshme. Edhe këtu në këtë seancë të fundit është angazhimi im”, ka theksuar prof. Shabanaj.

**Fadil Gashi**, tha se sa i përket buxhetit, e kemi debatuar edhe në KPF, me disa kërkesa që të gjithë anëtarët e KPF-së u pajtuan që ekzekutivi aq sa ka mundësi me ndryshuar sidomos në DB dhe të shëndetësisë, si programe të rëndësishme për investime kapitale. “E dyta, ato që po dëgjohen dhe janë dëgjuar në vazhdimësi, kërkesat janë shumë të arsyeshme dhe reale për secilin mjedis dhe për secilin mes, fshat e lagje ku ne jetojmë. Mundësitë e buxhetit nuk janë që të ketë një përfshirje për të gjithë, gabimi bëhet në hap kur nuk ndërtohen kriteret. Tash e shohim që në një fshat orientohen në asfaltimin e rrugëve lokale lagje më lagje, kur ke akoma fshat më fshat pa u lidhur. Këtu është te prioriteti, u potencua edhe Përqeva me Sferkë. Nuk ka nevojë të shkohet në një fshat me të gjitha projektet, po flas në parim, e nuk ka mundësi të gjendet mundësi për t'u respektuar largësia, vështirësitë cilat janë. Ose ujët, aty ku s'ka ujë që duhet për të qenë prioritet i orientuar drejt dhe unë besoj që asnjë prej anëtarëve të KK nuk kundërshton aty ku qytetarit i sigurohet ujët e pijshëm në cilindo fshat le të jetë ai, sepse është nevojë për të gjithë. Dhe nëse ishin ndërtuar këto kriteret kishte për të pasur më pak këso kundërshtime, më pak këso kërkesa. Unë i kuptoj edhe vështirësitë e buxhetit, ne nuk miratojmë për herë të parë buxhet, por të paktën kur t'i përmbahesh disa kriterëve i mbulon të gjitha. Unë po shoh sikur shumë të tjerë këtu, që një fshat në vazhdimësi investohet, ndonëse në një fshat tjetër sikur me qenë në Afrikë nuk investohet. Me këtë s'po mund të pajtohem. Pjesa tjetër ka mundësi për t'u riparuar nëse ka vullnet akoma. Ose siç po e shoh këtu bashkëfinancimi në vlerë prej 600 mijë euro. Ka mundësi të reduktohet pak aty ku është investuar shumë, sepse nuk i dëmtoni. Unë jam duke e kuptuar edhe këtë ngjyrën tjetër të fushatës. Ne mund t'i bëjmë disa përmirësime, me një vullnet të mira, me një orientim të drejtë. Besoni që keni nga 4-5 projekte në fshat. Desha të sqaroj për të gjithë, ngase me të gjithë po flas si anëtar i Kuvendit, rreth tatimit në pronë nuk ka nevojë të mburret as Komuna as ne të tjerët për t'u ankuar. As ju me u mburru, as ne të ankohe mi. Tatimi në pronë është i obligueshëm, është diçka që nuk na lëshojnë pa paguar. Në fund, jemi të gjithë taksapagues, përndryshe bartim pasoja tjera, por orientimi të jetë më balancues, nëse i bëni këto përmirësime po me duket që shumë

afër janë, nuk janë aq larg, besoj që gjejmë një koncensus të përbashkët. Është asambleja e fundit, buxheti nuk është i askujt. Me këtë buxhet cilido që i fiton zgjedhjet, me këtë buxhet ka për të punuar. Ne nuk mund ta bllokuar edhe po që se votojmë kundër. Është ministria që nuk na pyet as juve, as ne. Prandaj unë po dua ta kuptoj shumë drejt këtë punë, edhe për të gjetur “rrahmançe” këtë pjesë të buxhetit. A është për fushatë, a është për hatër të qytetarëve, ia lëmë kohës. I kemi ditë përpara. Një diçka kisha kërkuar prej të gjithëve: ne jemi njerëz që jetojmë në Klinë, mos dilni t’u thoni njerëzve, “s’po voton filani”, e s’po voton ky tjetri”. Të gjithë jemi kontribuues për aq sa mundemi, por përgjegjësia është e pushtetit. Ne jemi pjesë e kësaj asambleje, të gjithë japim kontribut. Nuk është njerëzore tash të shkojmë e t’u them i njerëzve këta deshën e këta s’deshën. Ne po flasim në parim për diçka që është jetike për qytetarët tanë. Buxheti është finalja e krejt vendimeve që ne nxjerrim në këtë Kuvend. Nuk vyen të bie kjo pjesë për të na humbur edhe tonin, edhe fjalën, edhe sjelljen,” ka konstatuar anëtari Gashi.

**Lorenc Marleku**, tha se edhe unë pajtohem me shumicën e atyre që nuk pajtohen që ky buxhet nuk është ndarë drejt. “Ne në shumë projekte duhet të planifikojmë edhe për 20 vjet të ardhshme si ka për t’u zhvilluar Klina, çfarë kahe ka për të marrë Klina. “po them që në Klinë ka aq shumë ndërtime pa kritere, të paligjshme, se Klina ka marrë një kahe të ndërtimit ashtu siç kanë dashur qytetarët, pa i ndalë askush, edhe pse Ministria ka marrë vendim për ndalje. Në pjesën e lagjen Arbëria, as për 2019 nuk planifikohet ndërtimi i asnjë shkolle apo i një çerdhe. Domethënë 5 km duhet udhëtuar nxënësit për të ardhur në shkollë. Te tabelat e rrugëve, më 2015 i kemi aprovuar ne, në asnjë komunë nuk ka ndodhur kështu. Nuk i keni paraparë numrat e shtëpive, se edhe ato kushtojnë. Prandaj nuk dimë t’u themi qytetarëve. Asfaltimi i rrugëve thotë “në pjesën periferike të qytetit”. Nëse kjo nuk specifikohet cila është rruga atëherë mundësia e manipulimeve është e madhe. Duhet kodi, numri i rrugës. Këtu po ashtu për ndriçim to rrugëve nuk ka asgjë. Rrugët janë të pandriçuar, kjo nuk i ndodh askujt. Të na sqarohet konstatimi që figuron këtu: 20 mijë euro për mirëmbajtje të ndriçimit. Me 20 mijë euro ndriçohen të gjitha rrugët e lëre të mirëmbahen. Këtë shumë kë në asnjë mënyrë nuk mund ta konceptoj nga mund të shkojnë këto mjete. Shkolla e Jagodës është akoma pa pullaz. Flitet që dy vjet për shkollën e Jagodës. Flasim për nxehjet qendrore nëpër shkolla aty pullazi është kancerogjen. Nuk dëshiroj të potencoj, mirëpo e theksoj ndonjëri këtu për Lugun e rinit 50 mijë euro, dika tjetër 220 mijë euro, kështu nuk është dashur të ndodh. Kudo në komunat e Dukagjinit kryetarët janë marrë vesh me opozitën rreth shpërndarjes së projekteve, vetëm në Klinë nuk ndodh. Prandaj, unë nuk pajtohem me shpërndarjen e këtij buxheti dhe nuk ka si pajtohem kur unë s’mund t’i dal nesër qytetarit për t’i kërkuar votën kur në lagjen Arbëria nuk investohet asgjë, as ndriçim, as asnjë projekt tjetër. Mbas 17 vjet pas luftës të potencojmë duhet për të pasur ujë, duhet pasur rrugë etj., nuk është arritje kjo. Buxheti i bujqësisë 40 mijë euro, kjo është e pajustificueshme. Klina është

vend agrar, vend i cili duhet për t'i kontribuar bujqësisë, zhvillim intensiv të bujqësisë, edhe qytetari ta ndjen veten mirë aty ku është në fshat”, ka pohuar anëtari Marleku.

**Sokol Bashota**, tha se fillimisht po i referohem Fadilit për ato fjalë, që rastësisht është i njëjti fjalim i sotëm sikurse edhe para katër viteve në këtë AK kur kam bërë thirrje për ta votuar buxhetin e Komunës së Klinës, për arsye se për buxhet s'i takon askujt, ju takon qytetarëve të Komunës së Klinës, dhe nuk ka lejuar që të politizohet më tepër për shkak të mundësisë së keqpërdorimit nga subjektet politike, qoftë ato që tash janë në pozitë, qoftë në opozitë. Dhe besoj që edhe tash ky buxhet duhet të trajtohet si i tillë dhe po e nis prej fjalëve të fundit “qytetarët dalin e shëtisin nëpër terr”. Le të shëtisin nëpër dritë, ka plot rrugë që janë të ndriçuara, bile-bile një pjesë e tyre dy herë qytetarët e kanë prishur ndriçimin. Shkolla në Jagodë, rinovimi i saj është nxjerrë nga Komuna, me 60 mijë euro. Dua të ndalem në pika të shkurtra të sqaroj vërejtjet që u dhanë rreth buxhetit. Buxheti është ky që është, këto 600 mijë euro, i sqaroi edhe drejtori, që janë nga preja buxhetore që ka bërë qeveria e cila iku dhe përqindëshi i garancionit që komuna iu ndalë kompanive deri sa të përfundojnë punimet. Dhe vlera është shumë e vogël që mbetet për bashkëfinancim me donatorë. U përmend shëndetësia, ju e dini se shumëçka varet prej qeverisë dhe përderisa është kështu, ne kemi bërë kontaktin e parë me ministrin e shëndetësisë dhe jemi akorduar që për vitin e ardhshëm të parashihen diku rreth 100 mijë euro, si dhe një autoambulancë përpos donacionit që kemi marrë nga qeveria japoneze, për një autoambulancë tjetër të një laboratorit që është modern, do t'i shtojmë edhe një autoambulancë të re dhe do të investohet edhe në këtë aneks ku frekuentimi i qytetarëve është më i madhi. U potencua lëvizja e projektit në Çabiq, për dijeninë e gjithëve janë lënë ato mjete më tepër për të participuar një një projekt së bashku me qeverinë zvicerane diku rreth 1 milion euro për 6-7 fshatra të asaj pjese, duke përfshirë Ujmirin, Çabiqin, Doberdolin, Gllarevën, Përqevën, Rixhevë, Stapanicë etj. U përmend rruga Sferkë - Përqevë, besoj që do të bëhet në vitin 2018, pra do të futet në prioritet të qeverisë për vitin e ardhshëm, që do të jetë në bashkëpunim me komunën e Klinës. Është një kërkesë e komuniteteve, jo vetëm të komunitetit serb, për një qendër kulturore në Videjë dhe ajo do të fillojë vitin e ardhshëm. Po ashtu në bujqësi, ju e dini që shpeshherë e kemi ngritur këtë problem këtu dhe problematikat që i kemi pasur në sektorin e bujqësisë për subvencionimin e fermerëve tanë dhe pengesat ligjore që na kanë dalë rreth subvencionimit të kësaj kategorie. Jam shumë i vetëdijshëm se Klina është një vend bujqësor dhe kjo nuk do të mbetet vetëm në domenin e vetëm të këtyre investimeve, por gjithsesi fermerët e Klinës tashmë direkt shkojnë në MB dhe do të përfitojnë subvencione nga projekte të ndryshme. Në bisedë me MB shuma e mjeteve për këtë kategori kap shumë bajagi të mëdha. Domethënë buxheti është në dakordancë edhe në raport me mundësitë buxhetore që i ka qeveria e Kosovës për komuna. Ujësbellësi në Sferkë, Valljak, Qupevë, e dimë gjendjen që është, edhe banorët e dinë që është duke punuar dhe ai brenda këtij viti do të përfundojë si projekt i këtillë. Ky është ndër projektet e para të

fshatrave që qeveria zvicerane është duke investuar dhe realisht është mirë që po e përmbyll edhe një kapitull shumë të rëndësishëm për arsye se po vendos kudo orëmatësit në fillim të lagjes, por edhe në të gjitha shtëpitë, për arsye se ujët sa ka ekzistuar është shfrytëzuar, mirëpo është keqpërdorur në mënyrë enorme nga vetë qytetarët, të cilët kanë qenë të lidhur ilegalisht. Po ashtu, edhe inkasimi ka qenë tepër i ulët. Tash, jo vetëm këtu, por në të gjitha vendet ku investohet kanë për të qenë orëmatësit. Po ashtu është paraparë zgjerimi dhe rruga deri te shkolla e Sferkës, prandaj edhe ajo është e planifikuar në këtë buxhet. Shkolla ne Cerovik, unë do të formojë një komision shpejt, ka dalë një kërkesë e vetë mësimeve se nuk i plotëson kushtet përkatësisht standardet si shkollë. Janë lënë ato 40 mijë euro, në qoftë se komisioni që do të formojmë vërteton se ajo shkollë nuk i plotëson kushtet për mësim dhe teknikisht nuk në gjendje të rregull, atëherë për ato mjete do të bëhet kërkesa, që është ajo dakordanca, për shkollë të Ujmirit dhe shkollë të Cerovikut, edhe me MASHT-in. Ky buxhet është diku 68 mijë euro më shumë se sa vitin e kaluar. Ky është një buxhet që duhet të miratohet. Është mirë të miratohet dhe të votohet nga të gjithë asamblistët. Realisht nuk e kemi pyetur shpesh opozitën për përpilimin totale, mirëpo i kemi marrë shumë vërejtje gjatë periudhës së debateve në asamble. Është ky buxhet që është. Realisht është jo vetëm një fundvit, por një fund mandat për të gjithë, prandaj do të ishte mirë si grup të votohet ta lëmë për të ardhmen Ju faleminderit shumë edhe për kontributin e dhënë, edhe besimin e juaj”, ka konstatuar kryetari Bashota.

**Marie Selmani**, kërkoi sqarim rreth rrugës në Radulloc.

**Baki Gashi**, sqaroi që bëhet fjalë për një rrugë lokale të këtij fshati që shtrihet në pjesën e sipërme të këtij fshati, përkatësisht në kodër, sqaroi drejtori Gashi.

Kryesuesi vuri në miratim buxhetin komunal për vitin 2018, bashkë me projektet, me ndryshimin që bëri Drejtorja e Financave.

**Me 20 vota për, pa kundër, 5 abstenime, u miratua buxheti i vitit 2018.**

Kryesuesi falënderoi anëtarët për miratimin e buxhetit.

**Pika e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i draft-rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.**

Kryesuesi foli rreth çështjes dhe procedurave nëpër të cilat ka kaluar kjo rregullore. “Ka qenë dakordancë e të gjithëve në KPF –së edhe partitë politike e kanë dhënë “izën”, mirëpo po që se dikush e dëshiron fjalën hap debatin rreth rregullore”, shtoi kryesuesi.

**Fadil Gashi**, theksoi se po sqaroi diçka që ma potencuat emrin më herët, pse nuk kam ndarë mirënjohje: e para për ta sqaruar se unë nuk e kam përfunduar vetë mandatin si

kryesues, prandaj nuk i kam dhënë askujt. E dyta, ka qenë e ndershme, edhe e rendit që edhe drejtorit t'i ndahet mirënjohje”, shtoi anëtari Gashi.

**Vlora Tafili**, tha se sa i përket rregullore uroj të mos preken disa çështje. “Tek neni, që propozohet të hiqet në tërësi, sepse leja për varrimin e të vdekurit duhet të lëshohet nga Drejtoria e SHP. Po çka po që se ai vdes ditën e shtunë apo të diel, kur drejtoria nuk punon, prandaj tek të hënë për ta varrosur. Duhet ta keni parasysh, sepse në implementimin e kësaj rregullore duhet shumë mjete, duke e parë gjendjen dhe mirëmbajtjen e varrezave të cilat janë sot në Komunën e Klinës. Mirëpo unë kam edhe disa hamendësime, që s’po them që janë të sakta. Unë mendoj që në këtë rregullore duhet të përshkruhen disa rite fetare, se unë i kam disa informacione se dimensionet e varreve të feja që i përkas unë dhe feja katolike dallojnë. Prandaj duhet përshtatur kërkesave të qytetarëve”, ka pohuar anëtarja Tafili.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi se në fund shkruan: “harmonizohen”.

**Tunë Dedaj**, tha se kjo rregullore është në të mirën e qytetarëve. “E kam vetëm një kërkesë që ajo shumë të ndahet në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët, pavarësisht çfarë kombi i takojnë, çfarë besimi i takojnë, le të jetë e barabartë”, shtoi anëtari Dedaj.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi që propozimi ka rrjedhë nga Zyra e Kryetarit, është debatuar në takimin me publikun, në KPF dhe sot ka mbërritur këtu për miratim, pra kemi kaluar nëpër të gjitha fazat.

**Arben Limani**, tha se vetëm desha të neni 6 i draftit, thjesht, të na sqarohet nga ata që kanë marrë pjesë në hartimin. “Ndoshta nuk është e drejt terminologji e duhur “varri neto” dhe “varri bruto”, të na sqarohet kjo terminologji”, pohoi anëtari Limani.

**Skënder Merturi**, tha se besoj që për këtë përbërje të asamblesë po flas për herë të fundit, shpresoj dhe besoj që legjislatura e ardhshme të jetë një përbërje më e mirë dhe në nivel më të lartë të përgjegjësisë. “E dyta, sa i përket kësaj rregullore, a është menduar që të bëhet renditja sepse të varrezat e Klinës aktualisht nuk ka renditje në mënyrë duhur dhe e kujt është kompetencë që të jetë renditja në mënyrë të duhur, se në Klinë shumë shpejtë do të zihet ajo hapësirë se është ndarë”, tha anëtari Merturi.

**Haxhi Ibishi**, tha e gjithë kjo rregullore është në funksion të këtyre çështjeve.

**Driton Raci**, sqaroi rregulloren. “Janë kryer të gjithë procedurat ligjore. Është organizuar diskutimi publik, ku janë marrë vërejtjet, propozimet, sugjerimet, të cilat sipas mundësive janë përfshirë në këtë draft-rregullore, si dhe në KPF-në e fundit ka qenë draft-rregullorja me disa propozime që janë dhënë, përkatësisht të hiqen disa nene të kësaj rregullore. Te neni 15, ku u propozua të hiqet, ndoshta drejtoria kompetente nuk mundet të përgjigjet ditëve pushimi, atëherë të hiqet tërësisht. Po ashtu neni 22 të hiqet në tersi. Propozimi i

Kuvendit është që shuma të jetë e barabartë, ekziston mundësia që me vendim të vecantë Kuvendi të caktojë një tarifë. Arben Limani përmendi tek neni 6, “sipërfaqja neto dhe bruto”, domethënë është paraparë si draft, sipërfaqja “neto” parasheh vendin, përkatësisht varrin, ndërsa “bruto”, parasheh hapësirën, gjegjësisht sipërfaqen rreth varrit. Sa i përket renditjes së varrit e potencoi z. Merturi, është paraparë gjatësia e rendit të varrezave, hapësirat gjelbëruese etj.. Ka mundësi që të hiqet edhe ky nen”, ka sqaruar zyrtari Raci.

**Sokol Bashota**, tha se unë kur kam bërë këtë propozim për t’ju dalë në ndihmë jam nisur nga disa faktorë, e para, kam vlerësuar se ka shumë familje të cilat nga varfëria nuk kanë mundësi t’i kryejnë shërbimet e varrimit. Aty hyn të gjithë pa ndonjë dallim fetar, racor apo ndonjë tjetër. Pritet miratimi me siguri edhe nga qeveria. Kemi menduar që tarifa e kompensimit të jetë në vlerë prej 200 euro. Nuk janë mjaft, mirëpo shpresojmë emergjenca kryhet. Mendoj që 200 euro janë të mirëseardhura. Zbatimi i kësaj projekt-rregulloreje bëhet prej 1 janarit 2018”, ka sqaruar kryetari Bashota.

**Ramiz Rrusta**, sqaroi rreth çështjes në shqyrtim. “Kjo kategori duhet të ndihmohet prej subvencioneve për momentin, pasi që nuk është miratuar në buxhet. Shprehjet “neto” dhe “bruto” duhet të hiqen si terminologji në këtë rregullore”, tha drejtori Rrusta.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se me rishikimin e buxhetit për vitin 2018 ka mundësi që të parashihet buxheti për këtë çështje, përkatësisht mund t’i gjendet pjesa financiare.

Vuri në miratim projekt-rregulloren.

**Me vota unanime (23) u miratua projekt-rregullorja.**

**Pika e pestë: Të ndryshme.**


Në vijim kryesuesi Ibishi, sqaroi anëtarët e KK dhe gjithë të tjerët që kanë marrë mandate publike, kanë për obligim ligjor sërish edhe në fund të mandatit të bëjnë deklarin e pasurisë, 30 ditë nga sot. Deklarimi mund të dorëzohet ose në zyrën tonë, në shërbim, ose në Agjencionin Antikorrupcion.

**Tunë Dedaj**, falënderoi të anëtarët e KK për bashkëpunimin. “Sot është seanca e fundit për këto katër vite, ju falënderoj juve kryesues, kryetarin, asamblastët, se kemi mundur ne jemi angazhuar që të punojmë për të mirën e qytetarëve. Mua asnjëherë nuk më është ndalur fjala, edhe për këto katër vite asnjë anëtar i Kuvendit nuk më ka demantuar as kundërshtuar. Prandaj i falënderoj të gjithë!”, u shpreh anëtari Dedaj.

**Haxhi Ibishi**, tha se desha një mesazh: “Për ata që kanë hyrë në garë, ju uroj sukses, atyre që nuk kanë hyrë në garë suksese në jetën e tyre edhe në aktivitetet shtesë që kanë në jetën e vet. Për mua, ju them me kompetencë dhe me ndjenjën personale në politikën time që jam marrë që 27 vjet e kam marrë veten si kryetar i këtij kuvendi, që duhet falënderoj kryetarin Bashota për mundësinë, që mos pengesën e drejtimit të këtij

Kuvendi. Dua të falënderoj të gjitha partitë që kanë qenë në koalicion e në veçanti opozitën e cila me debate të ndryshme ka ruajtur raportet e debatit. Ju uroj sukses! Vetë faktin që vitin tjetër përbërja e kuvendit do të jetë më e mirë se sa kjo që është, ka për të pasur kryetar më të mirë se unë, edhe sukses!- ka konstatuar kryesuesi Ibishi.

Procesmbajtësi,  
Mikel GOJANI



Kryesuesi i Kuvendit  
Dr. Haxhi IBISHI